

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire
Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Seanca Nr. 2003/ 19
Prishtinë, më 26 qershor 2003, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse bashkëkryesues ishte Gojko Saviq, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 91 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance, si vijon :

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për qasje në dokumentet zyrtare (2003/11)
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2002/5 për themelimin e Regjistrimit të të drejtave në pronën e paluajtëshme (2003/14)
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për naftën dhe prodhimet e naftës (2003/18)
5. Shqyrtimi i gjendjes së përgjithshme në arsimin e Kosovës
6. Miratimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në komisione parlamentare
7. Parashtrimi i pyetjeve
8. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 3 Korrik 2003

8.1 Shqyrtimi i procesit të privatizimit

8.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prokurimin publik (2003/13)

8.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për planifikimin hapsinor (2003/15)

Kryesuesi kërkoi nga deputetët e Kuvendit që të procedohet sipas rendit të ditës

Sabri Hamiti u pajtua me rendin e ditës dhe njëherit kërkoi që edhe Ministrinë tjera njësoj si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë të paraqesin raportet për punën e tyre para Parlamentit.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Nuk pati vërejtje lidhur me procesverbalin e seancës së mëparshme dhe ai u miratua.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për qasje në dokumentet zyrtare (2003/11)

Kryesuesi i vuri në votim amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike, Komisionit për Buxhet dhe të Grupit parlamentar "Kthimi", një nga një në këtë Projektligj.

Kuvendi pas votimit i miratoi amendamentet 1, 2, 3, 8 a, 9, 11, 15 a, dhe 16 b kurse refuzoi amendamentet 4, 5, 6, 7, 8 b, 10, 12, 13, 14, 15 b, dhe 17.

Kryesuesi e vuri në votim Projektligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon :

Për :Shumica
Kundër :14
Abstenime :0

Kryesuesi konstatoi :Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme (2003/14)

Kryesuesi i vuri në votim amendamentet e Komisionit për Shërbime Publike të përkrahura nga Komisionet Kryesore, një nga një në këtë Projektligj.

Kuvendi pas votimit i miratoi amendamentet 1, dhe 2.

Kryesuesi e vuri në votim Projektligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon :

Për :Shumica
Kundër :14
Abstenime :0

Kryesuesi konstatoi :Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave në pronën e paluajtshme.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për naftën dhe prodhimet e naftës (2003/18)

Kryesuesi e ftoi propozuesin Ministrin Ali Jakupi që të arsyetonte këtë Projektligj.

Ministri Ali Jakupi në fjalimin e tij e paraqiti këtë ligj si ligj me prioritet të lartë , i cili e ka përkrahjen e IPVK-ës, UNMIK-ut dhe komunitetit ligjot vendor që ishte rezultat i konsultimeve gjithëpërfshirëse me ekspert ligjor ndërkombëtar si dhe ata vendor .Ky ligj autorizon themelimin e bordit për mbikqyrjen e karburanteve si një Department brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë , bord i cili është i autorizuar që tu lëshojë licenca tregtarve me shumicë dhe pakicë të naftës për transport,deponim ose shitje të naftës.

Ligji mbi naftën është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e Kosovës sepse do të ndihmojë në:

- 1.Sigurimin e pagimit të plotë të përgjegjësve tatimor dhe të detyrimeve fiskale mbi naftën dhe produktet e naftës,
- 2.Inkurajimin për pjesëmarrje më të gjërë të sektorit privat dhe konkurrencës,
- 3.Mbrojtjen e konsumatorve të naftës dhe të produkteve të naftës dhe
- 4.Sigurimin e cilësisë dhe sigurimin e furnizimit të naftës dhe produkteve të naftës.

Në fund Ministri i Tregtisë dhe Industrisë Ali Jakupi ftoi deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta miratojnë këtë Projektligj.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në këtë Projektligj i dhanë deputetët Bajrush Xhemajli, Oliver Ivanoviq, Naim Maloku, Sabri Hamiti dhe Gojko Saviq, diskutimet e të cilëve janë pjesë përbërëse e transkriptit.

Pasi që vërejtjet e diskutantëve ishin përafërsisht të njejta sepse kishte vërejtje substanciale në këtë ligj , Kryesuesi propozoi që të mos vazhdohet debati i mëtejshëm dhe që ligji të tërhiqet në përpunim teknik dhe ato çështje që u potencuan nga ana e deputetëve Qeveria duhet ti ketë parasysh.

Konkludimi: Kuvendi nuk miratoi në parim Projektligjin për naftën dhe prodhimet e naftës (2003/18) dhe ngarkoi Qeverinë që të përgaditë tekstin tjetër të Projektligjit.

5. Shqyrtimi i gjendjes së përgjithshme në arsimin e Kosovës

Kryesuesi e ftoi propozuesin Ministrin Rexhep Osmanin të prezantonte raportin e punës njëvjeçare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Ministri Rexhep Osmani tha se pasi që raportin e punës njëvjeçare të MASHT deputetët e kanë marrë para një muaji do ti përmend vetëm disa pika kyçe të këtij raporti.

MASHT që nga fillimi veprimtarinë e ka bazuar në një udhëheqje profesionale të sistemit të arsimit, duke sajuar një plan të veprimit, i përqëndruar saktësisht se çfarë rezultatesh dëshiron të arrijë në këtë fazë të zhvillimit me qëllim të përmbushjes së nevojave për ndryshime.

MASHT për vitin e parë të veprimit planifikoi këto objektiva:

- kompletimin e infrastrukturës bazë të rregullativës ligjore,
- ndërtimin, zgjerimin dhe renovimin e objekteve shkollore në të gjitha nivelet e shkollimit,
- zbatimin e sistemit të ri të arsimit,
- zhvillimin e planprogrameve të reja mbi bazën e standardeve ndërkombëtare në të gjitha nivelet e shkollimit,
- hartimin dhe botimin e teksteve mësimore,
- aftësimin e mësimitdhënësve për zbatimin e metodologjive të reja në procesin e mësimitdhënjes dhe të mësimitdhënies në të gjitha nivelet,
- pajsa e shkollave me mjete të nevojshme mësimore,
- ngritja e qendrave për udhëheqjen e sistemit të informimit në arsim,
- përmirsimin e kushteve për rritjen e vijimshmërisë së nxënësve në shkollë,
- përmirsimin e bazës materiale dhe kushteve të punës për të gjithë punëtorët e arsimit, nxënësit dhe studentët,
- vazhdimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në të gjitha fushat e arsimit,
- zhvillimi i projekteve të ndryshme në zhvillimin e arsimit dhe prezentimin para donatorëve ndërkombëtar,
- riorganizimi i administratës në institucionet e arsimit, në pajtim me rregullativat ligjore.

Si pikë kyçe e zhvillimit të strategjisë së re që është duke përgaditur Ministria, ka të bëjë me unifikimin e sistemit të arsimit, sigurimin e hapësirës së nevojshme shkollore për të gjitha nivelet, sigurimit të arsimit për të gjithë, arritje të rezultateve të pranueshme të nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe inkurajimi i prindërve dhe shoqërisë në mbështetje të arsimit dhe informimi publik për rezultatet dhe vështirësitë në sistemin e arsimit.

Në kuadër të strategjisë për bashkëpunim me donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë Ministria nga 22-25 Maj 2003 organizoi Konferencën ndërkombëtare me donatorë në të cilën u konfirmua vullneti i donatorve kryesorë për vazhdimin e mbështetjes për arsimin Kosovar, pastaj u organizuan edhe dy seminare me nga 200 pjesëmarrës, ekspertë vendor dhe ndërkombëtar të cilët bënë hartimin e verzioneve përfundimtare dhe të programeve lëndore për klasën e parë, gjashtë dhe të dhjetë. Verzioni përfundimtar i programeve do të dorëzohet Këshillit të ekspertëve për programin e pjesës së dytë të korrikut kur edhe do të miratohen.

Kryesuesi i luti deputetët që së pari të shqyrtohen rekomandimet që janë bërë nga komisionet, dhe shefat e grupeve parlamentare e pastaj deputetët, me kërkesë që vlerësimet të mos përsëriten.

Hajredin Kuqi, në emër të Komisionit për arsim, shkencë dhe teknologji, në fillim ceku se kjo pikë e rendit të ditës ka ardhë si rezultat i kërkesës së Komisionit për arsim, shkencë dhe teknologji me qëllim të bëhet një diskutim i gjendjes së përgjithshme në arsim pas përfundimit të vitit shkollor apo akademik. Komisioni kishte fokusuar 4 çështje kryesore të cilat i propozoi për bisedime.

Çështja e parë ka qenë krijimi, apo respektimi i bazës juridike në fushën e arsimit, me kërkesë që të respektohet në tërësi Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm dhe Ligji për arsimin e

lartë,pra që ligjet e nxjerra në Kuvendin e Kosovës të zbatohen në tërë territorin e Kosovës,pra të jetë një unifikim në kuptimin juridik të sistemit arsimor.

Çështja e dytë e propozuar për diskutim është çështja e procesit të reformave në sistemin arsimor.Komisioni i përkrah reformat të cilat duhet të jenë të mbikqyrura nga organet kompetente e të cilat evaluohen nga viti në vit.

Çështja e tretë ka qenë krijimi i kushteve për shpërblim adekuat të mësimitdhënësve.Komisioni kishte kërkuar nga Qeveria që të bëhet një projekt i cili do të bëjë një zgjidhje adekuate dhe permanente.Si komision nuk kemi propozim konkret por kemi mbështetur format e participimeve që mund të bëhen në shkollim, formën e zhvendosjes së pjesës së buxhetit nga arsimit, një pjesë në pjesën tjetër apo edhe në tërësi nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Çështja e katërtë si fokusim kryesor i Komisionit por në tërësi edhe i sistemit arsimor është ngritja e cilësisë së punës në arsim me angazhimin më të madh të mësimitdhënësve dhe të stafit administrative dhe të kushteve për punën e tyre.

Në bazë të këtyre 4 çështjeve komisioni kishte ardhur deri te disa rekomandime të cilat i keni edhe ju e të cilat besoj se do të plotësohen edhe nga ana e juaj.Në fund kërkoi që rekomandimet të përkrahen nga Kuvendi, që Qeveria ti implemetojë në praktikë duke besuar se bashkarishtë do ta ndërtojmë një sistem arsimor çfarë i ka hije Kosovës.

Sabri Hamiti në diskutimin e tij tha se i sheh të barazvlefshme pikëpamjet e Ministrisë dhe të Komisionit dhe se vetë diskutimi në këtë nivel në seancën plenare na trimëron sepse shoqëria në përgjithësi në Kosovë do ti kthehet trajtimit fundamental të kësaj pjese të jetës sonë.Arsimi ka nevojë të mbështetet nga shoqëria jonë dhe nga institucionet kryesore.Nuk ka mundësi të përparohet sistemi i arsimit dhe të krijohen reforma nëse nuk ka bazë materiale.Unë insistoje, kjo është e përmendur edhe te raporti i grupit por edhe te i Ministrisë që në të gjitha nivelet të krijohet sistemi i vlerësimit dhe i diferencimit të vlerave.

Arsim Bajrami tha se hapi i parë në reformimin e arsimit në Kosovë është bërë me miratimin e dy ligjeve sistemore Ligjit për arsim fillor dhe të mesëm dhe Ligjit për arsimin e lartë të cilat janë hartuar me standarde ndëkombëtare falë asistencës që kanë dhënë ekspertët e Këshillit të Europës por tani ne duhet që me kritere profesionale të ndërtojmë një arsim çfarë i duhet Kosovës.I përkrahu masat që janë ndërmarrë në arsimin fillor dhe të mesëm dhe skemat e reja që tani janë europiane.

Arsimi i lartë poashtu është strukturuar në pikëpamje reformuese në bazë të frymës së Deklaratës së Bolonjës që është edhe fryma e ligjit për arsimin e lartë.Universiteti i Prishtinës është ndër Univerzitetet e para në rajon dhe në Europën Juglindore që është strukturuar në pikëpamje të këtyre skemave akademike.Univerzitetin e kemi reformuar në pikëpamje teorike dhe ligjore por nuk ia kemi arritur faktikisht ta reformojmë sepse këto skema reformuese nuk janë përcjellë me një tretman adekuat të shoqërisë dhe me nje kualitet çfarë na duhet.Për momentin kemi 2 sfida kryesore në arsimin e lartë.E para sigurimi i kualitetit dhe cilësisë me masa të planifikuara.Në Universitet kemi strategjinë për shtimin e kualitetit me një pako të masave që planifikojmë të ndërmarrim, dhe E dyta kriteri i dytë është tretmani adekuat shoqëror ndaj të punësuarve në arsim.

Në vazhdim tha se nuk dëshirojmë Institucione të veçanta për shqiptarët, për sërëbët, për pakicat tjera, Univerziteti i Prishtinës është i themeluar si një institucion i të gjithë qytetarve të Kosovës, dhe se pakicat tjera janë të integruara në Univerzitetin e Prishtinës me përjashtim të pakicës sërbe

Kërkoj që edhe ajo të heqë dorë nga institucionet etnike siç është Univerziteti i Mitrovicës dhe të fillojë të integrohet brenda Univerzitetit të Prishtinës.

Ka ardhur koha që të kemi një vision se çfarë Univerziteti na duhet dhe të fillojë të ndërrohet edhe metoda e menaxhimit të Univerzitetit në atë mënyrë që të lejohet që krahas parave nga Qeveria të lejohet që vetë ti krijojmë të ardhurat tona me projekte, me punë shkencore, me metoda të vetëfinancimit.

Në fund tha se me masat që ka filluar ti ndërmerr Ministria dhe me procesin e reformave jemi në rrugë të mirë që ndoshta për një kohë të shkurtër ta përmbyllim këtë proces të reformave dhe në një mënyrë të barazohemi me shtetet europiane në mënyrë që rinisë sonë për të cilën edhe kemi obligim ti sigurojmë një dije të pranuar, një dije me kritere profesionale, një dije të çmuar.

Bujar Dugolli theksoi se Grupi Parlamentar i Aleancës i mbështet rekomandimet e Komisionit për arsim ku edhe vet personalisht kishte marrë pjesë në hartimin e tyre. Nga ekspozeu i Ministrisë dhe nga raportet e shkruara dallon gjendja apo situata praktike në terren, me atë çka po i kemi si kërkesa apo angazhime. Shumë nga ato që u thanë nuk qëndrojnë apo qëndrojnë ndryshe në opinionin tonë.

Si grup parlamentar i sugjerojmë Ministrisë që kur të hartohen parametrat buxhetor për vitin e ardhshëm të insistojë me këmbëngulje që të rritet fondi apo buxheti për lëminë e arsimit. Çështje tjetër që na shqetëson është çështja e raporteve në mes institucioneve. Qeveria dhe Ministria duhet ta dijnë detyrën e vet siç duhet ta dijnë edhe institucionet arsimore, Universiteti apo sindikatat detyrat e tyre. Nuk duhet Qeveria apo Ministria të luaj rolin e tutorit dhe të përzirjes në autonominë e Univerzitetit.

Lidhur me metodën e participimit të studentëve ku sipas së cilës janë grumbulluar 4,5 milion euro tha se nuk ka rezultat konkret se ku u investuan këto mjete.

Kërkoj që institucionet e shkollimit të lartë të depolitizohen dhe që të ndalohen tubimet politike apo promovuese nëpër objekte univerzitare.

Në fund tha se i mbështesin rekomandimet dhe kërkoj që ato të zbatohen në praktikë e të mos mbeten rekomandime vetëm në letër.

Smiljka Milosavljeviq tha se koalicioni "Kthimi" i mbështet raportet e komisionit pasi që edhe vetë kishte punuar në mënyrë aktive në këtë komision me qëllim të ngritjes së nivelit të arsimit për të gjitha komunitetet të cilat këtu jetojnë. Ngritja e kualitetit të arsimit, pranimi i reformave të procesit arsimor duhet të jetë për të gjithë ne prioritet.

Kur është në pyetje arsimi i lartë për komunitetin serb ne kemi licencën për punë në pajtim me autonominë e univerzitetit, dhe i qasemi reformave në pajtim me deklaratën e Bolonjës.

Kur është në pyetje arsimi fillor dhe i mesëm, siç e dini gjatë vitit të kaluar kemi marrë lejen nga PSSP që me reforma të fillojmë një vit më vonë dhe ne këtë e kemi respektuar dhe që nga vjeshta do të fillojmë me reformën në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre i dhanë edhe deputetët Sadik Idrizi, Fatmir Sejdiu, Bajram Kosumi, Nimon Alimusa, Drita Statovci, Sanije Alijaj, Halil Ahmeti, Sala Ahmetaj, Edi Shukriu, Sabile Basha, Ramadan Kelmendi, Shefki Sejdiu, Edita Tahiri, Ismail Kurteshi, Melihate Tërmkolli, Xhezair Murati, Gjulshen Berisha, dhe Exhlale Salihu, diskutimet e të cilëve janë pjesë përbërëse e transkriptit.

Konkludim:

Në propozim të Kryesuesit, Kuvendi / me një abstenim dhe pa asnjë vot kundër/ miratoi Rekomandimet e Komisionit për arsim, shkencë dhe teknologji, në tekstin si vijon:

Kuvendi i Kosovës,
 Duke u nisur nga gjendja ekzistuese në arsim;
 Duke pasur parasysh nevojën për reformim të vazhdueshëm dhe përkrahje të këtyre reformave;
 Duke pasur parasysh se gjendja materiale në sistemin e arsimit nuk është e kënaqshme;
 Me qëllim të ngritjes së punës permanente të cilësisë në tërë sistemin arsimor miraton këto:

REKOMANDIME

1. Qeveria të angazhohet për hartimin e strategjisë së zhvillimit të sistemit arsimor në Kosovë dhe të behet miratimi i saj në Kuvendin e Kosovës;
2. Të unifikohet sistemi arsimor dhe të hiqen paralelizmat në këtë sistem;
3. Qeveria të angazhohet për përmirësimin e gjendjes materiale në arsim e shkencë dhe në afat prej një muaji t'i ofrojë Kuvendit një projekt të tillë për miratim;
4. Të nxirret Ligji për veprimtaritë shkencore;
5. Të krijohen standardet bashkëkohore për vlerësim;
6. Të definohet pozita aktuale dhe të ndihmohen Institutet ekzistuese dhe të stimulohet themelimi i të reja;
7. Qeveria të stimulojë bashkëpunimin e institucioneve tona arsimore dhe shkencore me ato ndërkombëtare;
8. Të bëhet profesionalizimi dhe profilizimi i shkollave të mesme në Kosovë;
9. Të vazhdohet me procesin e reformave në Universitetin e Prishtinës;
10. Qeveria të bashkëpunojë me institucionet arsimore dhe shkencore dhe t'i angazhojë ekspertët për nevojat e veta;
11. Qeveria të angazhohet vazhdimisht që institucionet tona arsimore dhe shkencore, të jenë laike dhe të depolitizuara;
12. Të bëhen propozimet për ndërtimin e objekteve të reja shkencore dhe arsimore dhe mirembajtjen e atyre ekzistuese për këtë të jipet përkrahje nga buxheti i konsoliduar i Kosovës;
13. Të bëhet një projekt i veçantë për stimulimin e kuadrave të reja dhe ngritjen e atyre ekzistuese;
14. Të krijohet Këshilli kombëtar për reforma në sistemin arsimor;
15. Të krijohet Fondi kombëtar për përkrahjen e veprimtarive shkencore;
16. Të behen projekte që nxisin aftësitë konkurruese në arsim.

Kryesuesi falenderoi për kontributin e dhënë për përmirësimin e cilësisë së punës në Kuvendin e Kosovës, Sekretarinë dhe në kushtet e punës zotin Franck Buolin ish sekretar gjeneral i Kuvendit dhe tash këshilltar i Kuvendit të Kosovës sepse është seanca e fundit e tij që merrë pjesë me ne, duke i dëshiruar të gjitha të mirat në Parlamentin Nacional në Francë me dëshirë që të vazhdojë bashkëpunimi edhe në të ardhmën.

6. Miratimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në komisione parlamentare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se kishin marrë kërkesën e grupit parlamentar të PDK për emërimin e anëtarëve në komisione parlamentare dhe propozimin e Kryesisë.

1. Deputeti **Bedri Selmani**, për anëtar në **Komisionin për Buxhet**, në vend të deputetës Sabile Basha, dhe
2. Deputetja Sabile Basha, për anëtar në **Komisionin për Shërbime Publike** në vend të deputetit Emin Krasniqi.

Lidhur me këtë Kryesuesi dha në votim këtë propozim dhe rezultati ishte:

Për : shumica
Kundër : asnjë
Abstenime : asnjë

Vendim:

Kryesuesi konstatoi se u miratuan anëtarët e propozuar për Komisionin për Buxhet dhe Komisionin për Shërbime publike.

7. Parashtrimi i pyetjeve

Deputeti Ramadan Kelmendi tha se me dt.28.5.2003 i është drejtuar Kryesisë me një propozim ligj që është shumë i rëndësishëm-propozimligji për shpalljen e personave si të zhdukur, të vdekur dhe promovimin e vdekjes për shkak se shumë qytetar nuk mund ti realizojnë të drejtat e tyre trashëgimore, pronëso-ro-juridike etj., dhe për të njejtin nuk ka marrë ftesë për paarsyeshmërinë e tij por as nuk ka hyrë në procedurë. Poashtu me 15.03. kishte bërë 3 pyetje Qeverisë dhe kërkoi përgjigje jo me shkrim por me gojë në këtë Kuvend.

Kryesuesi tha se sipas referimeve të zyrës për parashtrësia dhe propozime, në afatin e paraparë është konfirmuar përgjegjja gojore e Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë Ali Jakupi në pytjen e deputetit Ismail Kurteshi,

Ministri Ali Jakupi tha se kishte dy pyetje nga deputeti Ismail Kurteshi. **E para** kishte të bëjë me ngritjen e çmimit të bukës dhe ujit në komunën e Gjilanit. Sipas tij këto shtrenjtime janë bërë nga organet komunale (nga bordi i emëruar nga ana e AKM), duke u mbështet në rregulloren 2000/45 kapitulli 1 neni 3 alineja f) dhe l), sipas së cilës këto çështje janë në kompetencë të komunave. **E dyta** se çka kishte ndodhur dhe çështje ndërmarrë me ndërmarrjen “Eximkos” dhe “Gragjevinar”. Sipas tij me dt.12.06.2003 në bordin e AKM ku kishte marrë pjesë edhe vetë personalisht ai, është shqyrtuar situata në “Eximkos” lidhur me shitjen e aseteve në Beograd dhe gjetiu dhe çështja e ndërmarrjes në Shtërpece “Gragjevinar” e cila është privatizuar dhe blerë nga drejtori i asaj ndërmarrjeje, dhe lidhur për fajësinë, nivelin e keqpërdorimeve deri në kriminalitet dhe për ndërmarrjen e masave të mëtutjeshme është duke punuar zyra ligjore e AKM.

Kryesuesi tha se sipas referimeve të zyrës për parashtrësja dhe propozime, në afatin e paraparë është konfirmuar përgjegjësia gojore e Ministrit të Kulturës Behxhet Brajshori në pytjen e deputetit Alush Gashi.

Ministri Behxhet Brajshori tha se kishte pyetje nga deputeti Alush Gashi se çka ka ndërmarrë Ministria për ta mundësuar vazhdimin e aktivitetit të Qendrës së Pionerëve në Prishtinë. Sipas tij pas definimit të përgjegjësisë në mes Qendrës Rinore, Pallatit të Rinisë dhe Komunës, dhe me ndërmjetësimin e Ministrisë, është arritur marrëveshja që Qendrës Rinore ti mundësohet vazhdimi i kontratës mbi shfrytëzimin e objektit në pallatin e Rinisë deri në muajin shkurt 2004. Mbetet një aktivitet shtesë i inistrisë dhe i komunave në përgjithësi për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për të gjitha qendrat rinore në Kosovë.

Kryesuesi tha se sipas referimeve të zyrës për parashtrësja dhe propozime, në afatin e paraparë nuk është konfirmuar përgjegjësia nga Kryeministria në pytjen e deputetit Ramadan Kelmendi,

8. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 3 Korrik 2003

Kryesuesi propozoi rendin e ditës për seancën e ardhshme plenare me 3 korrik 2003, si vijon:

- 8.1 Shqyrtimi i procesit të privatizimit
- 8.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prokurimin publik (2003/13)
- 8.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për planifikimin hapsinor (2003/15)

Sabit Rrustemi tha se ka kohë që si Komision për Media kanë bërë kërkesë për një debat për çështjen e “Rilindjes” dhe të medimeve tjera për të cilat themelues më herët ka qenë Kuvendi i Kosovës. Të njëjtën kërkesë e propozoj që në seancën e ardhshme të hyjë në rendin e ditës

Kryesuesi tha se propozimin do ta shqyrton Kryesia.

Edita Tahiri propozoi që në rend dite të hyjë edhe gjendja e rëndë në PTK.

Kryesuesi tha se propozimi duhet të shkojë me procedurë të rregulltë..

Konkludim:

Kuvendi miratoi rendin e ditës së propozuar nga Kryesia, për seancën plenare me 3 korrik 2003.

Seanca përfundoi në ora 14:40

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat Daci